Partneret e Projektit

Anatoliki S.A. - Development Agency of Eastern Thessaloniki's Local Authorities (Greece)	GOLEA - Goriška Local Energy Agency (Slovenia)
FAMP - Andalusian Federation of Municipalities and Provinces (Spain)	Albania Ministry of Energy and Industry (Albania)
IRENA - Istrian Regional Energy Agency L.t.d. (Croatia)	AREANATejo - Regional Energy and Environment Agency from North Alentejo (Portugal)
Cyprus Energy Agency (Cyprus)	Climate Alliance Italy (Italy)
Gozo Development Agency – Gozo Regional Committee (Malta)	Intermunicipal Community of High Alentejo (Portugal)
Metropolitan City of Capital Rome (Italy)	

PROJECT INFO

Afati:	Buxheti i Projektit:	ERDF/IPA
30 Muaj (1/11/2016 – 30/04/2019)	**2.26 M €**	**1.92 M €**

https://enerj.interreg-med.eu

Kontakti i Projetit:

project@enerj-med.eu

https://www.energjia.gov.al
email: Alfred.Bundo@energjia.gov.al
Tel. +355 68 20 39136

@EnerjMED

Project co-financed by the European Regional Development Fund

Planet e Perbashketa per Eficensen e Energjise

ENERJ **(Planet e Përbashkëta për Efiçiencën e Energjisë)** është një projekt Interreg MED dhe ka për qëllim rritjen dhe përmirësimin e koordinimit të Planeve të Veprimit të Energjisë së Qëndrueshme (SEAP) dhe Planeve të tjera përkatëse të Efiçiencës së Energjisë. Projekti do të zhvillojë dhe testojë një metodologji të orientuar teknologjikisht për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike përmes Planeve të Përbashkëta duke transferuar metodat më premtuese në rajonet partnere.

Sfidat në implementimin dhe monitorimin e eficiences së energjisë në ndërtesat publike duke përdorur instrumente bashkëpunimi, duke nxitur bashkëpunimin dhe duke promovuar sipërmarrjet publike-private.

AKTIVITETET E PROJEKTIT

Njëmbëdhjete partnerë në nëntë vende të Mesdheut janë aktive për të rritur në rajonet e tyre dhe në të gjithë BE-në efiçiencën e energjisë në ndërtesat publike.

- Analizat e kontekstit në rajonet partnere ofrojnë baza për një metodologji të përbashkët për Planin e Perbashkët mbi Efiçiencën e Energjisë. Ajo do të përmbajë masat e parashikuara për efiçiencën në planet ekzistuese të energjisë (SEAPs), skemat e financimit dhe një përzgjedhje të ndërtesave në secilin rajon partner që do t'i nënshtrohen auditimeve të energjisë.
- TTë dhënat e energjisë për auditimet do të hyjnë në platformën e internetit së bashku me masat e EE të miratuara tashmë nga komunat, një metodologji për mënyrën se si do të hartohen dhe do të zbatohen planet e përbashkëta dhe udhëzimet mbi strategjitë e financimit. Platforma bashkëpunuese është një nga dy strategjitë kryesore të ENERJ.
- Gjithashtu është dhe Kordinatori i Planit të Përbashkët, i modeluar sipas linjave të menaxherëve të energjisë të bashkisë. Në qëndër të aktiviteteve do të jetë lidhja me autoritetet në nivel lokal dhe qarku dhe zhvillimi i ndërhyrjeve ndër-bashkiake me një projekt të përshtatshëm, mobilizimi i fondeve strukturore të BE-së dhe fondeve të tjera dhe përfshirja e ESCO-ve dhe palëve të tjera të interesit. Projekti do të organizojë trajnime për koordinatorët e përbashkët të planit.



TEMATIKA E KOMUNITETIT

Një rast specifik për kapitalizimin e përbashkët dhe transferimin është lidhja me Projektin Horizontal MEDNICE. Në arkitekturën e programit të MED-së 2014-2020 secili projekt është pjesë e një tematike të komunitetit, me objektivin kryesor të hartimit dhe zbatimit të metodologjive për: ndërtimin e komunitetit, lobimin/rrjetëzimin për të promovuar/transferuar rezultatet drejt institucioneve dhe rrjeteve në nivelin Mesdhetar/Europian, komunikimin e përbashkët, kapitalizimin/transferimin e përbashkët. ENERJ formon së bashku me nëntë projekte të tjera Tematikën e Komunitetit "Ndërtesa Efiçiente". Projekti horizontal MEDNICE është aktiv në krijimin dhe shfrytëzimin e sinergjive midis projekteve modulare.

TRANSFERIMI

Plotësuese për zhvillimin e një metodologjie për planet e përbashkëta territoriale dhe hartimin e tyre, është dhe një pjesë e rëndësishme e projektit, e cila do të jetë e përkushtuar për të vlerësuar në mënyrë krahasimore projektet pilot të zhvilluara në secilin rajon dhe për të përzgjedhur ato që do të transferohen midis partnerëve dhe në nivel Evropian.

REZULTATET E PRITURA

ENERJ do të përqëndrohet në përshpejtimin e reduktimeve të energjisë të ndërtesave publike në rajonet partnere siç është parashikuar tashmë në SEAPs apo plane të tjera të energjisë të komunave dhe qyteteve pjesëmarrëse. Ajo do të mbështesë zbatimin e masave të planifikuara duke prezantuar si element mbështetës platformën e internetit dhe do të lehtësojë planet e përbashkëta permes koordinatorëve të planeve të përbashkëta që duhet t'i bëjnë masat më tërheqëse edhe për investitorët private.

Projekti do të shqyrtojë dhe përshtasë gamën e gjerë të mjeteve dhe strategjive ekzistuese të financimit për nevojat e palëve të interesuara. Shkalla më e gjerë gjeografike (Niveli i qarkut/SEAPs të përbashkëta) dhe përfshirja aktive e aktorëve kryesorë do të kërkojnë ndërhyrje strukturore me kosto efektive.

PSE DUHET TE NDIQNI ENERJ?

Ju duhet të ndiqni projektin tonë nëse efiçienca e energjisë në ndërtesa është një çështje e juaja dhe doni të dini më shumë rreth financimit dhe planeve të përbashkëta. Ne do t'ju informojmë për punën e vazhdueshme nëpërmjet Facebook, twitter, buletinit tonë dhe faqes tonë të internetit, por ju jeni më se të mirëpritur të kontaktoni direkt me ne, duke shkruar një email tek project@enerjmed.eu ose Alfred.Bundo@energjia.gov.al